



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë-Albania

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 270 Prot.

Tiranë, më 19.03 .2015

**V E N D I M**

Nr. 26 , datë 19.03 .2015

Bazuar në nenet 11, 14 dhe 15, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenet 80-104, të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", mora në shqyrtim materialin e administruar dhe relacionin e Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ mbi verifikimin e kryer në institucionin e Institutit të Statistikave, në lidhje me statusin e punësimit për punonjësen \*\*\*\*\* . Pasi u njoha me Vendimin Nr. 160/1 Prot., datë 29.01.2014, "Për transferimin e përkohshëm", shkresën Nr. 306 Prot., datë 18.02.2015, "Vendim për moskonfirmimin nëpunës civil", aktin Nr. 306/1 Prot., datë 20.02.2015, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës", aktin e deklarimit të statusit të punësimit Nr. 1208/194 Prot., datë 19.01.2015, që ka revokuar aktin Nr. 1208/3 Prot., datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, për punonjësen \*\*\*\*\* ,

**V Ë R E J:**

Në datën 19.01.2015, Komisioneri për Mbiqëqyrjen e Shërbimit Civil ka marrë dijeni për disa parregullsi të kryera e lejuara nga njësia e personelit të INSTAT Tiranë dhe njësia përgjegjëse, në lidhje me aktin Nr. 160/1 Prot., datë 29.01.2014, "Për transferimin e përkohshëm" të punonjësës \*\*\*\*\* dhe disa veprime të tjera që kanë shoqëruar këtë transferim. Bazuar në sa më sipër, Komisioneri për Mbiqëqyrjen e Shërbimit Civil, me Urdhër Nr. 85/1 Prot., datë 23.01.2015, filloi procesin e verifikimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe praktikës së administruar nga Instituti i Statistikave, si dhe shpjegimet e Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, rezultoi se:

Punonjësja \*\*\*\*\* ka marrë pjesë në konkursin e shpallur nga Zyra Rajonale e Statistikave Durrës për pozicionin vakant "*Specialist i statistikave bujqësore*" sipas Ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*" (ligji i zbatueshëm në atë kohë). Në përfundim të procedurës së konkurimit është shpallur fituese dhe me aktin Nr. 398/3 Prot., datë 05.06.2013, është emëruar në pozicionin "*Specialist i statistikave bujqësore*" kategoria IV-b, në periudhë prove për një vit, pranë Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës.

Me aktin Nr. 160/1 Prot., datë 29.01.2014, "*Për transferimin e përkohshëm*", të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave, mbështetur në Nenin 17, të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*", për nevoja pune, kjo punonjëse është transferuar për një periudhë 6-mujore nga data 29.01.2014 deri më datë 31.07.2014, në pozicionin "*Specialist në sektorin e statistikave të tokës dhe prodhimit bimor*" në Drejtorinë e Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit pranë Institutit të Statistikave Tiranë.

Me marrjen dijeni të përmbajtjes së aktit, punonjësja \*\*\*\*\* , me kërkesën ankimore Nr.160/5 Prot., datë 31.01.2014, drejtuar Institutit të Statistikave, ka kundërshtuar transferimin, duke theksuar se: 1. ai është i paarsyetuar; 2. është kryer pa marrë pëlqimin e saj, pa respektuar kërkesat e ligjit, e konkretisht Nenit 17, të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, "*Statusi i nëpunësit civil*, pasi distanca nga vendi aktual i punës është më larg se 30 km.

Me shkresën Nr. 160/6, datë 12.02.2014, "*Kthim përgjigje*", drejtuar \*\*\*\*\* , Instituti i Statistikave ka sqaruar se transferimi i përkohshëm i saj është konsideruar i domosdoshëm për arritjen në kohë të objektivave të institucionit, për shkak të pamundësisë së rekrutimit të punonjësve sipas ligjit të ri.

Me kalimin e afatit 6-mujor, punonjësja \*\*\*\*\* pretendon se ka kërkuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore e Mbështetëse pranë Institutit të Statistikave të rikthehet në pozicionin e saj të punës si "*Specialist i statistikave bujqësore*" pranë Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës, por rezultoi se edhe pas kalimit të afatit për transferimin e përkohshëm ajo ka vazhduar të kryejë detyrën si "*Specialist në sektorin e statistikave të tokës dhe prodhimit bimor*" në Drejtorinë e Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit pranë Institutit të Statistikave Tiranë.

Nga provat e administruara gjatë këtij procesi hetimor rezultoi se Instituti i Statistikave, me shkresën Nr. 922 Prot., datë 31.07.2014, i ka kërkuar mendim Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me mënyrën e procedimit në rastin e punonjësës \*\*\*\*\* , pas përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm, pasi në pozicionin që ajo mbante përpara transferimit si "*Specialist i statistikave bujqësore*" pranë Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës ishte emëruar, në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, ish punonjësja e këtij institucioni \*\*\*\*\* , e cila më parë kryente detyrën e përgjegjësës së sektorit.

Departamenti i Administratës Publike, në përgjigje të kërkesës së mësipërme të Institutit të Statistikave, me shkresën Nr. 1944/1 Prot., datë 22.09.2014, "*Kthim përgjigje*", bazuar në Nenin 48, pika 4, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*" dhe Vendimin Nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave, Kreu I pika 12, është shprehur se në përfundim të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozicionin e mëparshëm. Gjithashtu, Departamenti i Administratës Publike, me të drejtë ka sqaruar, se vendet e punës ku më parë

punonin nëpunësit e transferuar përkohësisht, nuk janë vende vakante në kuptim të Ligjit Nr.152/2013, "Për nëpunësin civil" e për këtë shkak nuk janë pozicione të hapura për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatës, për procedura të lëvizjes paralele apo për procedura të pranimit në shërbim civil.

Ne vijim, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit të Institutit të Statistikave, ku punonte e transferuar përkohësisht punonjësja \*\*\*\*\* , në fund të periudhës së provës, me shkresën Nr. 160/8 Prot., datë 26.05.2014, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave (për dijeni Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mëshetëse), ka kërkuar që të zgjatet periudha e provës dhe e vlerësimit të rezultateve individuale edhe për gjashtë muaj të tjerë, deri në datën 05.12.2014, me arsyetimin se: "puna që ka kryer gjatë periudhës së transferimit e bënte të pamundur një vlerësim të plotë të rezultateve individuale në punë brenda harkut kohor prej një viti të periudhës së provës". Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave, me shkresën Nr. 160/9 Prot., datë 30.05.2014, e ka miratuar këtë kërkesë, duke theksuar se zgjatja e periudhës së provës deri më datë 05.12.2014 për punonjësën \*\*\*\*\* , për shkak të pamundësisë të vlerësimit të plotë, mbështetet në Nenin 24, pika 3/b, e Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në VKM Nr.143, datë 12.03.2014, "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese", Kreu 5, pika 7 / b.

Nga aktet e administruara, konstatohet se Instituti i Statistikave nuk e ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike për zgjatjen e periudhës së provës dhe ky i fundit, me aktin Nr. 1208/3 Prot., datë 30.10.2014, ka konfirmuar statusin e punësimit për punonjësën Veronika Mina, si nëpunëse civile në pozicionin "*Specialist i statistikave bujqësore*" në Zyrën Rajonale të Statistikave, Durrës.

Me marrjen dijeni për deklarin e statusit, Instituti i Statistikave, me shkresën Nr. 430/195 Prot., datë 30.12.2014, "*Kthim përgjigje dhe informacion sqarues*", ka vënë në dijeni Departamentin e Administratës Publike, se për shkak të pamundësisë për kryerjen e vlerësimit të \*\*\*\*\* , më datë 30.05.2014 është bërë zgjatja e afatit të transferimit deri më 05.12.2014 (edhe pse me shkresën Nr.160/9 Prot., datë 30.05.2014, është miratuar "*zgjatja e periudhës së provës deri më 05.12.2014*" dhe jo e transferimit).

Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të Nenit 124 të Kodit të Procedurave Administrative dhe bazuar në informacionin e dërguar nga Instituti i Statistikave, pa marrë në konsideratë faktin se edhe afati 6-mujor i shtyrjes së provës kishte kaluar, ka revokuar aktin e konfirmimit të statusit Nr. 1208/3 Prot., datë 30.10.2014, dhe me aktin Nr. 1208/194 Prot., datë 19.01.2015, ka deklaruar statusin e punësimit të saj si "*nëpunëse civile në periudhë prove*", në pozicionin në të cilin ishte transferuar përkohësisht "*Specialiste në sektorin e statistikave të tokës dhe prodhimit bimor*" në Drejtorinë e Statistikave të Bujqësisë, pranë Institutit të Statistikave Tiranë.

Drejtori i Drejtorisë së Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në Institutin e Statistikave, duke mos mbajtur parasysh faktin që punonjësja ishte e transferuar përkohësisht në këtë pozicion, pasi fillimisht ishte emëruar në pozicionin "*Specialiste e statistikave bujqësore*", në

Zyrën Rajonale të Statistikave Durrës, me shkresën Nr. 306 Prot., datë 18.02.2015, "Vendim për moskonfirmimin nëpunës civil", ka vendosur moskonfirmimin e punonjësës \*\*\*\*\* si nëpunëse civile, për shkak të vlerësimit jo-kënaqshëm të rezultateve individuale në punë gjatë periudhës një vjeçare të provës (edhe pse, *periudha e provës për këtë punonjëse ka vazhduar për një afat 18-mujor*) dhe rezultatin negativ të testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Bazuar në sa sipër, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave, me aktin Nr. 306/1 Prot., datë 20.02.2015, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës", ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare në datë 26.02.2015.

Duke analizuar sa më sipër, konstatohet se:

**Së pari**, transferimi i punonjësës Veronika Mina për një periudhë 6-mujore në pozicionin "Specialist në sektorin e statistikave të tokës dhe prodhimit bimor", në Drejtorinë e Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit pranë Institutit të Statistikave Tiranë, me aktin Nr. 160/1 Prot., datë 29.01.2014, "Për transferimin e përkohshëm", të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave, është kryer për nevoja pune, duke u bazuar në Nenin 17, të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", i cili ishte efektiv në kohën e daljes së aktit. Në zbatim të Nenit të sipërpërmendur dhe Nenit 48, pika 4, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", me kalimin e afatit 6-mujor, nëpunësja \*\*\*\*\* duhet të kthehet në vendin e saj të punës ku ishte emëruar fillimisht si "Specialiste e statistikave bujqësore" pranë Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës.

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstatohet se Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të Institutit të Statistikave nuk ka mbajtur parasysh dhe nuk ka zbatuar kufizimet e parashikuara nga dispozita e Nenit 17, të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", në fuqi në kohën e nxjerrjes së aktit për transferimin e përkohshëm të punonjësës \*\*\*\*\* , në të cilin përcaktohet se: "... Nëpunësi civil nuk mund të detyrohet të pranojë transferimin nëse vendi i ri i punës është më larg se 30 km nga vendi i punës aktual. ”.

Në arsyetimin fillestar të aktit të transferimit për nevoja të institucionit është argumentuar domosdoshmëria e këtij veprimi me faktin e pamundësisë për të bërë rekrutimet e reja për efekt të kohës së shkurtër. Gjatë periudhës 6-mujore konstatohet se, nga ana e Institutit të Statistikave, nuk është bërë procedura e plotësimit të vendeve vakante, për shkak të së cilave është kryer transferimi, në mënyrë që, në përfundim të afatit 6-mujor, të mos kishte vështirësi në kryerjen e punës në atë drejtori. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe, në shkelje të ligjit, vendi i lënë vakant i punonjësës \*\*\*\*\* është plotësuar në zbatim të një vendimi të formës së prerë të gjykatës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit.

Instituti i Statistikave nuk ka patur parasysh as kërkesat e Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" dhe përcaktimet e bëra në VKM Nr. 171, datë 26.3.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", Kreu I, pika 3, në të cilën përcaktohet se: "Transferimi i përkohshëm nuk bëhet për nëpunësit civilë në periudhë prove.....".

Veç kësaj, Instituti i Statistikave nuk ka marrë në konsideratë as sqarimin e bërë nga Departamenti i Administratës Publike, dërguar me shkresën Nr. 1944/1 Prot., datë 22.09.2014, në lidhje me rikthimin në pozicionin e mëparshëm si "Specialist i statistikave bujqësore" pranë Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës të punonjësës \*\*\*\*\* , në të cilin thuhet shprehimisht: "... bazuar në Nenin 48, pika 4, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në përfundim të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozicionin e mëparshëm.". Instituti i Statistikave, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, ka vijuar ta mbajë punonjësën \*\*\*\*\* në pozicionin "Specialist në sektorin e statistikave të tokës dhe prodhimit bimor", në Drejtorinë e Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit, pranë Institutit të Statistikave Tiranë. Qëndrimi i punonjësës \*\*\*\*\* në këtë pozicion tej afatit ligjor përbën shkelje të ligjit dhe të të drejtave të nëpunësit civil.

Këto veprime kanë passjellë veprime të tjera administrative në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kanë çuar në nxjerrjen e akteve administrative që në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative janë akte administrative të pavlefshme dhe si të tilla duhet të konsiderohen nga organi që i ka nxjerrë, duke bërë edhe revokimin e tyre.

Sa më sipër, konstatojmë se akti administrativ Nr. 160/1 Prot., datë 29.01.2014, "Per transferim të përkohshëm", i ka mbaruar efektet e tij që në datën 31.07.2014, kohë kur nëpunësja \*\*\*\*\* duhej të ishte kthyer në vendin e saj të punës. Zgjatja e këtij afati tej parashikimeve ligjore është një veprim administrativ i pavlefshëm, që ka passjellë pavlefshmërinë e veprimeve të mëvonshme. Për rregullimin e ligjshmërisë në këtë rast duhet që Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të Institutit të Statistikave të procedojë me kthimin e nëpunësës \*\*\*\*\* në pozicionin e punës "Specialist i statistikave bujqësore" pranë Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës.

**Së dyti**, i pambështetur në ligj e në prova është edhe pretendimi i zgjatjes së afatit të provës edhe për një periudhë tjetër 6-mujore. Edhe pse në këtë vendim Instituti i Statistikave i është referuar dispozitave ligjore, e konkretisht Nenit 24, pika 3/b, të Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" dhe VKM Nr. 143, datë 12.03.2014, "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese", Kreu 5, pika 7 / b, rezulton se nga ana e tyre nuk janë zbatuar as kërkesat e këtyre dispozitave, e konkretisht Nenit 24, pika 3/b, e Ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në të cilën përcaktohet se: "Në fund të periudhës së provës, institucioni, ku nëpunësi është i emëruar, vendos: b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit". Kjo lidhet ngushtësisht me pikën 4 të po kësaj dispozite, në të cilën përcaktohet se: "4. Vendimi, sipas pikës 3 të këtij neni, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve individuale në punë dhe në rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s.",

Bazuar në sa më sipër, konstatojmë se nuk jemi përpara rasteve të parashikuara nga kjo dispozitë, pasi kjo kërkesë nuk ka ardhur për shkak të pamundësisë së vlerësimit të plotë të nëpunësës apo të jetë bazuar në vlerësimin e rezultateve individuale, si dhe në rezultatin e testimit nga ASPA. Nga provat e administruara rezulton se në pjesën e parë të periudhës së

provës, gjatë kohës kur nëpunësja ka qenë duke ushtruar detyrën pranë Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës, ajo është vlerësuar me “shumë mirë”.

Veç kësaj, nuk janë patur parasysht as kërkesat e Nenit 68, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në lidhje me ligjin e zbatueshëm për procedurat e nisura, sipas të cilit: “Çdo procedurë tjetër në proces, nisur përpara shtrirjes së efekteve të këtij ligji, do të përfundohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”. Në tërë aktet administrative të dala për punonjësen V. Mina nuk është patur parasysht kjo kërkesë e ligjit.

**Së treti,** Departamenti i Administratës Publike, në aktin e deklarimit të statusit të punësimi Nr.1208/3 Prot., datë 30.10.2014, me të drejtë e ka mbështetur këtë akt në Nenin 67, të Ligjit Nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”. Ndërkohë, referimi në Kreun III, pika 1, e VKM Nr.116, datë 05.03.2014, “Për Statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit Nr. 152/2013, ‘Për nëpunësin civil’”, është i gabuar. Rasti në fjalë duhet trajtuar në bazë të dispozitës së pikës 4, të Kreut IV, të VKM 116, datë 05.03.2014, në të cilën përcaktohet se: “nëpunësit civilë, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, parashikuar nga Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, dhe që janë në periudhë prove, vazhdojnë periudhën e provës sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj” dhe deklarimi i statusit duhet të përmbante edhe saktësimin “në periudhë prove”. Në kuptim të dispozitave ligjore që rregullojnë deklarimin e statusit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike duhet të ishte verifikuar statusi i kësaj punonjëseje në ditën e fillimit të efekteve të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Akti Nr. 1208/194, datë 19.01.2015, i Departamentit të Administratës Publike, që ka revokuar aktin e mëparshëm Nr. 1208/3 Prot., datë 30.10.2014 dhe ka ribërë deklarimin e statusit të punësimi të nëpunëses \*\*\*\*\* si “Specialiste në sektorin e statistikave të tokës dhe prodhimit bimor, në periudhë prove” në Drejtorinë e Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit pranë Institutit të Statistikave Tiranë, vjen në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe duhet të revokohet nga vetë organi që e ka nxjerrë, si një akt administrativ i pavlefshëm. Kjo për faktin se:

- a) deklarimi i statusit të punësimi është bërë në një pozicion të ndryshëm nga ai në të cilin punonjësja ishte emëruar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”;
- b) në momentin e daljes së këtij akti, periudha e provës kishte përfunduar (duke patur parasysht edhe zgjatjen prej 6 muajsh të periudhës së provës). Për më tepër, duheshin marrë masat për përfundimin e procedurës së vlerësimit dhe konfirmimit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, të kombinuara këto me nenet 24 dhe 68, pika 2, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe pikat 4 dhe 5, të Kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Bazuar në sa më sipër, Departamenti i Administratës Publike duhet të revokojë aktin Nr.1208/194 Prot., datë 19.01.2015, “Për deklarimin e statusit të punësimi”, duke lënë në fuqi aktin Nr. 1208/3 Prot., datë 30.10.2014, për deklarimin e statusit të punësimi në pozicionin

*“Specialist i Statistikave Bujqësore”, në Zyrën Rajonale të Statistikave Durrës, me shtesën “në periudhë prove” pas deklarimit “ \*\*\*\*\* është nëpunës civil”.*

**Së katërti**, parregullsi u konstatuan edhe në procesin e vlerësimit të punonjësës \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*, gjatë të cilit nuk janë patur parasysh kërkesat e ligjit e konkretisht, të Kreut V, pika 6, të VKM Nr. 143, datë 12.3.2014, *“Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele...”*, në të cilin përcaktohet se: *“vendimi në përfundim të periudhës së provës merret bazuar në: a) rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA; b) vlerësimin e rezultateve individuale në punë”.*

Në rastin konkret, ndryshe nga sa ka konkluduar eprori që ka bërë vlerësimin, punonjësja në fjalë rezultoi se e ka kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit në ASPA dhe është vlerësuar me 21 pikë nga 28 pikë të mundshme, gjë e cila nuk ka gjetur pasqyrim dhe nuk është mbajtur parasysh gjatë procesit të vlerësimit.

Procesi i vlerësimit, kryer nga Përgjegjësi i Sektorit të Statistikave të Tokës dhe Prodhimit Bimor, kundërfirmuar nga Drejtori i Drejtorisë së Statistikave dhe Mjedisit, përmban parregullsi të cilat konsistojnë në drejtim të afatit të vlerësimit dhe kompetencës materiale të vlerësimit. Në këtë vështrim, konstatohet se organi vlerësues, në fund të periudhës së provës, duhej të ishte eprori i pozicionit të punës ku nëpunësja kishte konkuruar dhe ishte pranuar në shërbimin civil dhe jo ata eprorë që e kanë patur në vartësi nëpunësen në fjalë, për shkak të transferimit të përkohshëm, edhe pse ky transferim, në shkelje të ligjit, ka zgjatur mbi 6 muaj. Shkelja e lejuar në respektimin e kësaj procedure e bën aktin e vlerësimit të dalë në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë nuk duhet të merret parasysh.

Veç kësaj, akti i vlerësimit ka parregullsi edhe në drejtim të përmbajtjes së tij; konkluzioni përfundimtar i vlerësimit nuk është rrjedhim llogjik i vlerësimit të zërave të veçantë. Konkretisht, në aktin e vlerësimit përpiluar në Drejtorinë e Statistikave dhe Mjedisit në Institutin e Statistikave Tiranë, shihet se kemi vlerësime të nivelit 2 (dy vlerësime), vlerësime të nivelit 3 (pesë vlerësime), vlerësime të nivelit 4 (tre vlerësime) dhe në përfundim kemi vlerësim në nivelin 4. Ndërsa në periudhën e parë të vlerësimit në Zyrën Rajonale të Statistikave Durrës, nëpunësja është vlerësuar në nivelin e përgjithshëm me 1.

Sigurisht, vlerësimi përfundimtar nuk është një mbledhje aritmetike e vlerësimeve për rubrika të veçanta, por sidoqoftë, ky vlerësim duhet të jetë rrjedhim llogjik dhe integral i vlerësimeve të veçanta. Vlerësimi negativ në fund të periudhës 18 majore është i pajustificuar, për shkak se:

- a. punonjësi është mbajtur i transferuar padrejtësisht, tej limiteve ligjore, gjë e cila, në mënyrë të pashmangshme, duhet të ketë patur ndikimin e vet edhe në arritjen e rezultateve në punë;
- b. vlerësuesi i periudhës së fundit kishte për detyrë të përgjigjej vetëm për kohën që nëpunësja e vlerësuar kishte punuar nën drejtimin e tij dhe jo për periudhën e mëparshme, për të cilën ajo ishte vlerësuar nga eprori i mëparshëm;
- c. vlerësimi përfundimtar i nëpunësës në fjalë duhej bërë në pozicionin ku kishte konkuruar dhe ishte emëruar si nëpunës civil në periudhë prove;

- d. në fund të periudhës 6-mujore të transferimit, punonjësja \*\*\*\*\* duhej të ishte kthyer në vendin e saj të punës dhe aty duhej të merrte vlerësimin në fund të periudhës së provës.

Në vlerësimin e nëpunësit civil në periudhë prove duhej mbajtur parasysh se ajo ishte pa përvojën e duhur, gjë që prezumon ndihmën edhe kujdesin e vazhdueshëm nga një punonjës i vjetër (*sipas Kreut V, pikat 3 dhe 4, të VKM Nr. 143, datë 12.03.2014, gjë e cila në rastin konkret nuk rezulton të jetë bërë*) dhe matja e rezultateve në punë duhej bërë në mënyrë relative; nuk mund të jetë tregues negativ, siç është shënuar në formularin e vlerësimit (në zërin "*Kërkesat për këshillim*"), kërkesa prej nëpunësit civil në periudhë prove për shpjegime dhe këshillime të vazhdueshme nga eprorët apo punonjësit më me eksperiencë, për aspekte të ndryshme të punës, siç vëren pa të drejtë eprori në aktin e vlerësimit.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se akti i vlerësimit përfundimtar është kryer në shkelje të procedurës dhe nuk është rrjedhim llogjik i vlerësimeve të veçanta, prandaj si i tillë duhet të revokohet nga organi që e ka kryer dhe të dërgohet për rivlerësim tek eprori direkt i Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës.

Si rrjedhojë, duhet të revokohen nga organi që i ka nxjerrë, Instituti i Statistikave Tiranë, shkresa Nr. 306 Prot., datë 18.02.2015, "*Vendim për moskonfirmimin nëpunës civil*" dhe akti Nr.306/1 Prot., datë 20.02.2015, "*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës*".

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 15, pika 1, të Ligjit Nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Instituti i Statistikave Tiranë, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në veprimet dhe aktet administrative që lidhen me punonjësën \*\*\*\*\* \*\*\*\*, të revokojë shkresën Nr. 306 Prot., datë 18.02.2015 "*Vendim për moskonfirmimin nëpunës civil*" dhe aktin Nr. 306/1 Prot., datë 20.02.2015, "*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës*".
2. Të kërkoj nga Instituti i Statistikave Tiranë, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, punonjësja \*\*\*\*\* të kthehet në pozicionin e saj të punës si "*Specialiste e statistikave bujqësore*" pranë Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës, për shkak se akti Nr. 160/1, datë 29.01.2014, "*Për transferim të përkohshëm*", i ka mbaruar efektet.
3. Të kërkoj nga Instituti i Statistikave Tiranë të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të dërguar praktikën e vlerësimit individual të punës të punonjësës \*\*\*\*\* për rivlerësim tek eprori direkt i Zyrës Rajonale të Statistikave Durrës.



4. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të revokojë aktin për deklarimin e statusit të punësimit Nr. 1208/194 Prot., datë 19.01.2015, duke lënë në fuqi aktin Nr. 1208/3 Prot., datë 30.10.2014 dhe, në zbatim të Nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative, pas deklarimit " \*\*\*\*\* është nëpunës civil", në pozicionin "Specialist i Statistikave Bujqësore" në Zyrën Rajonale të Statistikave Durrës, të shtohet shprehja "në periudhë prove".
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative lihet afat 15 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, Departamenti i Administratës Publike dhe Instituti i Statistikave duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **K O M I S I O N E R I**

**Pranvera STRAKOSHA**